

PYETJE: «NË QOFTË SE PERËNDIA ËSHTË I MËSHIRSHËM, A MUNDËT QË NJERËZIT E MIRË, TË NDESHËM DHE TË SINQERTË TË HUMBASIN?»

PËRGJIGJE: Ne besojmë në mësimin e Biblës se njerëzit mund të shpëtohen vetëm pasi, duke pranuar Jezusin si Birin e Perëndisë dhe duke iu bindur Atij, zhyten në ujë (pagëzohen) për faljen e mëkateve. Dhe pas kësaj ata duhet të jetojnë një jetë të bindur ndaj vullnetit të Perëndisë, të cilin Ai na e ka bërë të njohur nëpërmjet Biblës. Njerëzit shpesh reagojnë ndaj kësaj të vërtete duke thënë: «Po, duket se Bibla e thotë këtë, por çfarë do të ndodhë me gjithë njerëzit fetarë që nuk janë pagëzuar? Ata janë njerëz të mirë, të ndershëm dhe të sinqertë. Si është e mundur që ata të mos shpëtohen?» E para, ne po diskutojmë për njerëzit që besojnë te Krishti, për njerëzit e mirë, të ndershëm, të sinqertë dhe fetarë, por që kurrë nuk janë pagëzuar sipas Biblës. A mundet që këta njerëz të humbasin?

Le ta zgjerojmë objektin e kërkimit tonë. Do të jetë një gabim po të themi se vetëm ata që e quajnë veten e tyre kristianë janë njerëz të mirë, të ndershëm dhe të sinqertë. Disa kanë arritur në përfundimin se Perëndia nuk ekziston. Ata me mirësi, ndershmëri dhe sinqeritet kanë arritur në atë përfundim. A mundet që këta njerëz të mirë, të sinqertë dhe të ndershëm, por që nuk besojnë në ekzistencën e Perëndisë, të humbasin?

Po me ata njerëz që besojnë te Perëndia, por nuk e pranojnë Krishtin si Birin e Perëndisë dhe si shpëtimtarin e tyre, çfarë do të ndodhë? Çfarë do të ndodhë me hebrenjtë apo myslimanët që e pranojnë Perëndinë, por nuk pranojnë Krishtin si Birin e Tij, si rrugën e vetme që të çon te Perëndia? Ata gjithashtu janë të ndershëm, të mirë dhe të sinqertë

ashtu si edhe shumë kristianë. A mundet që ata të humbasin?

ÇFARË NA MËSON BIBLA?

Le të fillojmë duke pyetur: Çfarë na mëson Bibla për këtë temë? Është e arsyeshme dhe për më tepër e drejtë të shikojmë se çfarë thotë Perëndia, se sa atë që të tjerët besojnë. E vetmja mënyrë për të njohur fjalën e Perëndisë është studimi i librit të Tij, Biblës. Atëherë, sipas Biblës a mundet që këta njerëz të humbasin?

Le t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje duke bërë këto pyetje:

Për ata që nuk besojnë në ekzistencën e Perëndisë, le të pyesim: «A mund të shpëtohen ata, nëse nuk besojnë në Perëndi?» Mbani parasysh se te 2 Thesalonikasve 1:7-9 thuhet se Krishti do të vijë me zjarr përvëlues për t'u hakmarrë ndaj atyre «që nuk e njohën Perëndinë dhe nuk iu bindën ungjillit të Jezu Krishtit». Hebrenjve 11:6 thotë se pa besim nuk mundet të kënaqësh Perëndinë, sepse ai që do të vijë te Perëndia duhet «të besojë se Ai është». A tingëllon kjo sikur dikush mund të jetë ateist dhe prapë të shpëtojë? Një ateist tha se në qoftë se ai ishte gabim dhe do të ballafaqohej me Perëndinë në gjykimin pas vdekjes, ai do t'i kërkonte falje Perëndisë dhe bashkë me të edhe Perëndia do të qeshte me shakanë e bërë. Por, sipas Biblës, kjo nuk është e vërteta!

E dyta, le të pyesim jokristianët e sinqertë: «A mundet të shpëtoheni pa besuar te Krishti?» Çfarë na mëson Bibla? Sipas Gjonit 8:24, Jezusi tha: «. . . sepse po të mos besoni se Unë jam, ju do të

vdisni nga mëkatet tuaja.» Te Gjoni 14:6, Ai tha: «. . . askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet Meje.» Nuk ka asnjë rrugë tjetër me anë të të cilës mund të shpëtohem përveçse nëpërmjet Krishtit dhe emrit të Tij (Veprat 4:12). Pavarësisht se sa shumë e admirojmë një njeri që nuk është kristian për karakterin dhe veprimet e tij të shkëlqyera, në qoftë se pranojmë atë që thotë Bibla, ne nuk mund të mendojmë se ai do të shpëtohet, në qoftë se ai mbetet një jobesimtar.

E treta, konsidero ata që e quajnë veten kristianë dhe që janë në rrugë të gabuar fetare. Ne nuk po flasim për kristianë të dobët dhe që bëjnë gabime. Ne po flasim për ata që pretendojnë të jenë kristianë, por nuk janë pagëzuar sipas Biblës. A do të shpëtohen ata? Le t'i pyesim ata: «*A mundet të shpëtoheni pa iu bindur ungjillit?*» Imagjinoni një njeri që është anëtar i një grupi fetar. Ai është i mirë, i ndershëm dhe i sinqertë në atë që beson, por ai kurrë nuk është pagëzuar sipas Biblës. A mund të shpëtohet ai pa iu bindur kësaj urdhërese të Biblës? Te 2 Thesalonikasit 1:7–9, Pali jo vetëm tha se Krishti do të hakmerrej ndaj atyre «që nuk e njohin Perëndinë», por se Ai, gjithashtu, do të hakmerret ndaj atyre që «nuk i binden ungjillit». Një njeri nuk mund të shpëtohet pa iu bindur ungjillit të Jezusit (Mateu 7:21–23). Në qoftë se dikush mendon se ky rregull është shumë i rreptë, ne mund të përgjigjemi se rregullat nuk i vendosëm ne, por *Perëndia!* Thjesht mendoni: si ka mundësi të shpëtohet një njeri, kur ai nuk ndjek rrugën që Perëndia vetë ka përcaktuar për shpëtimin.

A është e mundur, atëherë, që njerëz të mirë, të ndershëm dhe të sinqertë të humbasin? Mendoni për këtë: Korneli ishte një njeri i mirë (Veprat 10:1–4), por ne e dimë se ai ishte i humbur, sepse kishte nevojë të dëgjonte fjalët me anë të të cilave mund të shpëtohej (Veprat 11:14, 15). Etiopiani ishte një njeri që e lexonte fjalën e Perëndisë, por ai kishte nevojë kaq të madhe për shpëtim, sa Perëndia dërgoi Filipin t'i predikonte atij (Veprat 8). Sauli ishte njeri i mirë, i ndershëm dhe shumë i zellshëm për fenë në të cilën ai besonte. Megjithatë, kur u bë kristian, e kuptoi se s'ishte as më shumë dhe as më pak se sa mëkatari më i madh (Veprat 23:1). Ju mund të jeni një njeri me moral të mirë, por shpirtërisht të ndarë nga Perëndia, të sinqertë, por të gabuar në sinqeritetin tuaj, të ndershëm, por të gabuar në ndershmërinë tuaj! Të gjithë kemi parë shembuj të tillë. Për shembull, në Australi katër

foshnja vdiqën në një spital sepse, sipas ekspertizës, njëri nga infermierët kishte zëvendësuar kripën me sheqer në mënyrë krejt të pavetëdijshme ndërsa përgatiste ushqimin për këta fëmijë. Fajtori nuk u gjend kurrë, sepse ndoshta as ai vetë nuk e dinte që kishte gabuar. Sidoqoftë, dikush kishte zëvendësuar kripën me sheqer. Dhe ka mundësi se ai apo ajo që e bëri këtë gaboi sinqerisht, pa e ditur as vetë çfarë po bënte. Megjithatë, edhe pse gabimi ishte i sinqertë, pasojat ishin tragjike: katër fëmijë vdiqën.

Në një rast të ngjashëm në Kanada, pesë foshnje vdiqën kur një infermiere në spital zëvendësoi ujin e distiluar me solucion acid borik. Një gabim i sinqertë shkaktoi një tragjedi të tillë.

Një tren pasagjerësh në New York duke udhëtuar me shpejtësi u përplas me një tren tjetër që po vinte përballë. Si rezultat i kësaj përplasjeje, pesëdhjetë vetë gjetën vdekjen. Makinisti kishte ngecur mbrapa motorit të trenit me gjakun që i rridhte nga hundët dhe lotët që i mbulonin faqet. Gjatë agonisë së vdekjes ai mbante në dorë një copë letre të verdhë e të zhubrosur. «Merre këtë», tha ai. «Kjo letër do t'ju tregojë se dikush më dha urdhërat e gabuara!» Fundi mund të jetë fatal edhe kur ne me sinqeritet ndjekim udhëzime të gabuara.

Por, në qoftë se njerëzit e mirë, të sinqertë dhe të ndershëm mund të humbasin, kjo ngre një pyetje të dytë.

SI ËSHTË E MUNDUR QË ATA TË HUMBASIN?

Në qoftë se Perëndia është i mëshirshëm, si është e mundur që njerëz të tillë të humbasin?

Ndërsa fillojmë të diskutojmë këtë pyetje, ne duhet të themi këtë: *Në qoftë se Bibla është sadopak e vërtetë, një kufi duhet vendosur diku midis të humburve dhe të shpëtuarve, sepse disa do të humbasin.* Në këtë moment duhet të mendojmë me një llogjikë të ftohtë dhe jo të lejojmë emocionet dhe ndjenjat tona të na udhëheqin drejt përfundimeve të gabuara. Bibla na mëson se disa do të humbasin. Meqënëse disa do të humbasin, secili që beson Biblën ballafaqohet me pyetjen: Pse do t'i ndëshkojë Perëndia këta njerëz? Dhe nëse ata që thonë se janë kristianë dhe në fakt ata janë njerëz të mirë, të sinqertë, e të ndershëm do të humbasin, sepse ata nuk i janë bindur *plotësisht* ungjillit, çdo të ndodhë me ata që nuk kanë një standard kaq të lartë? Ata me siguri do të humbasin.

Imagjinoni se ne duhet të vendosim se ku duhet vendosur vija që do të përfaqësonte ndarjen midis të humburve dhe të shpëtuarve. Le ta vendosim vijën në mënyrë të tillë që «besimtarët e papagëzuar» të jenë në anën e «të humburve». «Ju nuk mund ta bëni këtë», dikush mund të thotë. Pse jo? «Sepse këta besimtarë të papagëzuar janë njerëz të mirë, të ndershëm dhe të sinqertë dhe Perëndia nuk do t'i dënojë njerëzit e mirë, të ndershëm dhe të sinqertë.» Kështu e lëvizim vijën me qëllim që «besimtarët e papagëzuar» të përfshihen në anën e «të shpëtuarve», por «ata që nuk besojnë në Krishtin» janë në anën e «të humburve». «Jo kjo nuk është e drejtë», dikush tjetër thotë. Pse jo? «Sepse këta njerëz janë të mirë, të ndershëm dhe të sinqertë dhe Perëndia natyrisht nuk do të dënojë njerëzit që besojnë në Të, vetëm se nuk kanë pranuar Krishtin.» Kështu, përsëri e lëvizim vijën që «jokristianët» të kalojnë në anën e «të shpëtuarve», por «ateistët» (njerëz që jo vetëm nuk besojnë te Perëndia, por që luftojnë çdo shfaqje të besimit tek Ai) të mbeten në anën e të humburve. «Ndaloni! Ju s'mund ta hiqni vizën këtu!», një tjetër insiston. Pse jo? «Sepse disa ateistë janë moralisht po aq të mirë sa edhe kristianët më shembullorë. Në fund të fundit, për të shkuar në qiell mjafton të jesh i sinqertë dhe t'i trajtosh të tjerët siç duhet. Dhe natyrisht Perëndia nuk do të dënojë një njeri të tillë, që thjesht nuk beson tek Ai. Sigurisht Perëndia nuk do të dënojë as ateistët që janë të mirë, të ndershëm dhe të sinqertë.» Kështu, ne duhet të lëvizim vijën përsëri dhe të përfshijmë madje edhe ateistët në anën e «të shpëtuarve».

Së fundi këtu ne mund të gjejmë gjuhën e përbashkët, meqënëse ata që janë tani në anën e «të humburve» nuk janë njerëz të mirë, të ndershëm dhe të sinqertë. Dhe shumica nga ne janë të gatshëm të thonë: «Po, Perëndia mund të dënojë jobesimtarët të cilët *nuk* janë të mirë, të ndershëm dhe të sinqertë.»

Përpara se ta lëmë vijën këtu, me njerëzit e këqinj, të pandershëm dhe jo të sinqertë që do të ndëshkohen, ne përsëri dëgjojmë kundërshtime: «E vërtetë, ata nuk janë të mirë», dikush thotë, «por a e dini arsyen?» «Ata janë të sëmurë, mendërisht apo fizikisht», thotë mjeku. «Ata nuk kanë edukimin e duhur», thotë mësuesja. «Ata janë të abuzuar nga shoqëria», thotë sociologu. «Mjedisi i tyre i bëri ata ashtu si janë. Ju s'mund t'i fajësoni», thotë psikologu. «Ata janë të parapërcaktuar për ferr», thotë një ndjekës i John Kalvin. «Ata nuk kanë pasur

mundësinë që të studiojnë Biblën», thotë një anëtar i kishës, «kështu ata aq dinë». Në disa nga këto pohime gjendet një e vërtetë. Si rrjedhim, pyetja vijon: «Kur nuk është në të vërtetë faji i tyre, si mund t'i dënojë Perëndia ata edhe pse nuk janë njerëz të mirë, të ndershëm dhe të sinqertë?»

Në këtë moment ne jemi gati t'i përfshijmë të gjithë në anën e të shpëtuarve! Por ne nuk mundemi! Nëse e bëjmë një gjë të tillë, gjëja e parë që duhet të bëjmë më pas është të flakim Biblën tutje, me gjithë mësimet e saj se disa do të humbasin!

Atëhere, ku duhet ta vendosim vijën? E vërteta është se vija duhet vendosur diku! *Kudo që e vendosim vijën, në anën e «të humburve» do të ketë njerëz që janë të mirë, të ndershëm dhe të sinqertë ose njerëz që nuk janë të mirë, të ndershëm dhe të sinqertë, por që mendojnë se mund të shfajësohen për këtë!*

Me fjalë të tjera, ne që predikojmë se pagëzimi është themelor për shpëtim nuk jemi të vetmit njerëz që ballafaqohen me problemin nëse njerëzit e mirë, të ndershëm dhe të sinqertë që besojnë një mësim të ndryshëm nga ai i Biblës do të humbasin. Në dosjet e mia kam një artikull të titulluar «*Feja e Vërtetë*», të shkruar nga një kristian, anëtar i një kishë protestante¹. Me të vërtetë, kushdo që deklaron se është kristian duhet të bjerë dakort me çfarë ai thotë. Kristianizmi, sipas Biblës, është feja e vërtetë! 30% e popullsisë botërore deklarojnë se janë kristianë. Por kjo do të thotë se pjesa tjetër e popullsisë botërore, plot 70% e kësaj popullsie, është e humbur! Çfarë duhet të besojmë për ata që janë njerëz të mirë, të ndershëm dhe të sinqertë të cilët nuk janë pjesë e asaj që ai i quajti «feja e vërtetë»?

Ne kemi treguar se problemi i njerëzve të mirë, të ndershëm dhe të sinqertë që janë të humbur është një problem universal, me të cilin përballet çdo njeri që beson ndonjë gjë rreth Krishtit apo Biblës. Por ne akoma nuk i jemi përgjigjur pyetjes: Pse do t'i ndëshkojë Perëndia këta njerëz?

Përgjigjja e kësaj pyetjeje gjendet në tre fakte të rëndësishme të theksuara nga Bibla: E para, të gjithë kanë mëkatuar (Romakëve 3:23). E dyta, mëkatarët meritojnë vdekjen. Romakëve 6:23 thotë: «Sepse paga e mëkatit është vdekja, . . .» Fjala «paga» tregon se vdekja është pasoja e mëkatit tuaj, sepse ju e meritoni atë. Ju keni mëkatuar dhe për shkak të mëkatit tuaj meritoni të vdisni. E treta,

njeriu nuk mund të shpëtojë veten e tij. Në mëkat, ne jemi të pashpresë dhe të dënuar me vdekje. Ne gjithashtu jemi të pafuqishëm dhe nuk mund të shkëputemi nga mëkati me forcat tona. Kështu, pavarësisht sa të mirë jemi, sa të mira dhe të moralshme janë jetët tona dhe sa punë të mira bëjmë, ne nuk mund të paguajmë dot për mëkatet tona.

Problemi i shumë njerëzve është se ata besojnë se mirësia, ndershmëria dhe sinqeriteti i tyre në një farë mënyre do të balancojnë mëkatin e tyre. Ata e dinë që kanë mëkatuar. Por ata besojnë se ata janë aq të mirë, të ndershëm dhe të sinqertë sa që mëkatet e tyre do të falen dhe ata do të qëndrojnë të justifikuar përpara Perëndisë. *Por Bibla nuk na mëson këtë!* Ajo na mëson se e gjithë mirësia, ndershmëria dhe sinqeriteti që gjenden në botë nuk mund të shpëtojnë as edhe një njeri të vetëm!

Ne kemi përgjigjen tonë për pyetjet: «Si është e mundur që njerëz të mirë, të ndershëm dhe të sinqertë të humbasin? Pse do t'i ndëshkojë Perëndia njerëz të tillë?» Arsyja nuk është dëshira e Perëndisë për të ndëshkuar njerëzit; Perëndia është dashuria vetë dhe dëshiron që të gjithë njerëzit të shpëtohen. Por, ndëshkimi vjen për arsye të mëkatis të njerëzve, ata kanë rebeluar kundër Perëndisë. Dhe gjithë çfarë ata i ofrojnë Perëndisë për të paguar për mëkatet e tyre është mirësia e tyre, e cila kurrë nuk mund të jetë e mjaftueshme.

ATËHERE, KUSH MUND TË SHPËTOHET?

Atëhere, kush mund të shpëtohet? Në qoftë se mirësia, ndershmëria dhe sinqeriteti janë të pamjaftueshëm në vetvete që të garantojnë shpëtimin e njeriut, në qoftë se njerëzit e mirë, të ndershëm dhe të sinqertë mund të humbasin, kush mund të shpëtohet? Përgjigjja është e thjeshtë: Të vetmit njerëz që mund të shpëtohen tani dhe në përjetësi janë ata që nuk e mbështesin shpëtimin e tyre në mirësinë, ndershmërinë dhe sinqeritetin e tyre, por në gjakun e Krishtit, ata që shpëtohen me anë të gjakut!

Mendoni se çfarë bën gjaku. Ai *pastron ndërgjegjen*: «Sa herë më shumë gjaku i Krishtit, . . . do ta pastrojë ndërgjegjen tuaj nga veprat e vdekura për t'i shërbyer Perëndisë së gjallë?» (Hebrenjve 9:14). Gjaku *fal mëkatet e njeriut*. Jezusi tha: «Sepse ky është gjaku Im, gjaku i besëlidhjes së re, i cili është derdhur për shumë për faljen e mëkateve» (Mateu

26:28). Ai *lan mëkatet*. Zbulesa 1:5 thotë: «Atij që na deshi dhe na lau nga mëkatet tona në gjakun e Tij.»

Natyrisht, është gjaku i Jezusit që na shpëton. Ai shkatërron mëkatin që na dënon, që na vret dhe që na ndan nga Perëndia. Por si ndodh kjo? Çfarë duhet të bëjmë që të kemi faljen me anë të këtij gjaku?

Gjaku pastron ndërgjegjen tonë gjatë pagëzimit. 1 Pjetrit 3:20, 21 thotë:

. . . kur durimi i Perëndisë i priste në ditët e Noeut, ndërsa po ndërtohej arka, në të cilën, pak vetë, gjithsejt tetë, shpëtuan nëpërmjet ujit, i cili ishte shembëllesa e pagëzimit, jo heqja e ndyrësisë së mishit, po kërkesa e një ndërgjegjeje të mirë të Perëndia, . . .

Gjaku gjithashtu fal apo heq mëkatin *gjatë pagëzimit*. Te Veprat 2:38, hebrenjve besimtarë iu tha: «. . . Pendohuni dhe secili nga ju le të pagëzohet në emër të Jezu Krishtit *për faljen e mëkateve* dhe ju do të merrni dhuratën e Frymës së Shenjtë.» Dhe gjaku lan mëkatin *gjatë pagëzimit*. Te Veprat 22:16, Saulit të penduar i thanë: «Dhe tani ç'pret? Çohu dhe ji i pagëzuar dhe i larë nga mëkatet e tua, duke thirrur emrin e Zotit.» Në qoftë se do të pyesnim se ç'lidhje ka pagëzimi me gjakun e Krishtit të derdhur në kryq, atëherë Romakëve 6:3, 4 do të shërbente si përgjigje: «Po a nuk e dini se ne të gjithë që u pagëzuam në Jezu Krishtin, u pagëzuam në vdekjen e Tij? Ne, pra, u varrosëm me të me anë të pagëzimit në vdekje, që, ashtu si Krishti u ringjall prej së vdekurish me anë të lavdisë së Atit, kështu edhe ne gjithashtu të ecim në risinë e jetës.» Kur Bibla thotë se ne jemi pagëzuar në vdekjen e Krishtit, kjo heq çdo dyshim për rëndësinë e pagëzimit, sepse e lidh atë përgjithmonë me gjakun e Krishtit. Kështu, mirësia, ndershmëria dhe sinqeriteti nuk do t'ju shpëtojnë. Vetëm gjaku i Krishtit mund ta bëjë atë! Por për marrë shpëtimin me anë të gjakut të Krishtit, ju duhet të pagëzoheni në Krisht!

SI MUND TË SIGUROHEMI PËR SHPËTIMIN?

Si mund të sigurohemi për shpëtimin? Ç'duhet të bëjë *secili prej nesh* për të mësuar me *siguri absolute* se është i shpëtuar. Përgjigja është e qartë:

E para, *a e kemi dëgjuar fjalën e Perëndisë?* «Besimi, pra, vjen nga dëgjimi dhe dëgjimi vjen nga fjala e Perëndisë» (Romakëve 10:17). E dyta, a

besojmë se Jezusi është Biri i Perëndisë? «... Sepse po të mos besoni se Unë Jam, ju do të vdisni në mëkatet tuaja» (Gjoni 8:24). E treta, *a jemi penduar për mëkatet tona?* «... Nëse ju nuk pendoheni, do të vdisni të gjithë me të njëjtën mënyrë» (Luka 13:3). E katërta, *a kemi qenë të gatshëm t'u bëjmë të njohur të tjerëve besimin tonë në Jezun Krishtin?* «Sepse me zemër, njeriu beson në drejtësi dhe me gojë bëhet rrëfim për shpëtim» (Romakëve 10:10). E pesta, *a jemi pagëzuar sipas Biblës për faljen e mëkateve?* «Pendohuni dhe secili nga ju le të pagëzohet në emër të Jezun Krishtit për faljen e mëkateve dhe ju do të merrni dhuratën e Frymës së Shenjtë» (Veprat 2:38).

Thjesht, bëhuni kristianë të Testamentit të Ri. Në qoftë se do t'u bindeni urdhëresave të Perëndisë, ju mund të jeni të sigurtë se do të jeni me Të, përjetësisht. Atëherë, pavarësisht se çdo të bëjë Perëndia me të tjerët, ju vetë do të jeni të sigurt se jeni në anën e duhur të «vijës» që ndan të shpëtuarit nga të humburit!

KONKLuzioni

Le të bëjmë një pyetje të fundit: *A jeni me të vërtetë të mirë, të ndershëm dhe të sinqertë?*

A jeni me të vërtetë «të mirë» në qoftë se ju nuk u jeni bindur urdhëresave të Perëndisë?

A jeni me të vërtetë «të ndershëm» në qoftë se nuk i bindeni asaj që e konsideroni si të vërtetë? Ju ndoshta mund të thoni: «Por dikush tjetër nuk e njohu të vërtetën e shpëtimit dhe nuk iu bind asaj.» Ndoshta jo, por ndoshta ai nuk kishte të njëjtën mundësi që ju keni. Ai atëherë mund të thotë ndershmërisht: «Unë nuk dija më shumë.» Por a mund të thoni ju të njëjtën gjë, kur ju dini më shumë? A është e ndershme të mos veproni duke u bazuar në të vërtetën që tashmë e dini?

A jeni me të vërtetë «të sinqertë» në qoftë se vendosni që të mos i kushtoni vëmendje Biblës dhe ndiqni rrugën tuaj, sikur të mos e kishit dëgjuar të vërtetën kurrë? A jeni ju, në këtë rast, me të vërtetë i sinqertë në pretendimin tuaj se doni të njihni dëshirën e Perëndisë dhe t'i bindeni vullnetit të Tij?

Pavarësisht se të tjerët nuk janë të mirë, të ndershëm dhe të sinqertë, a jeni *ju i tillë?*

SHËNIME

¹ Grupet fetare apo kishat që u krijuan pas shkëputjes nga trungu i Kishës Katolike dhe, duke filluar që nga viti 1529, protestuan ndaj pushtetit të Romës dhe Papës. Pionieri i kësaj lëvizjeje ishte predikuesi gjerman Martin Luther (1486–1546).

Autor: *Coy Roper*
Marrë nga studimi: *"Pyetje lidhur me besimin te Perëndia"*
© 2001, 2003 E VERTETA PER SOT
Të gjitha të drejtat të rezervuara